

# SHTESË KONTRATË

E lidhur sot në datë 01.07 2015, në Bashkinë Ersekë, midis palëve:

1. Bashkia Ersekë, me seli ne Ersekë, në adresën: “Sheshi “Rilindja”, referuar si “Autoriteti Kontraktor”, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, zoti Ali LAHO.
2. Shoqëria Tregtare “AS” sh.p.k., njohur si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 33547 datë 23.05.2005, me seli në Durrës, në adresën: “Lagjia 3, Rruga “Egnatia”, pallati 15 katesh, kati shtate, prane shtëpise se pionierit”, mbajtëse e NIPT-it K51901503L, referuar si “Kontraktori”, spërfaqësuar nga administratori zoti Asllan KONI.

të cilët me vullnet të lirë dhe të pavesuar, ranë dakord si më poshtë:

## Neni 1

### Baza ligjore

1. Kontrata shtesë do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999, ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin nr.17/2012., Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 14 të kontratës së nënshkruar mes palëve më datë 25/07/ 2014.
2. Bazuar në dokumentat standarte të tenderit, preventivin e shtesës me sasi të dhe cmimet e ofruara nga Kontraktori, bazuar edhe ne kërkesën e Kontraktorit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve shtesë për shkak të kthimit te Sheshit “Rilindja” në pedonal, rritjes së vëllimit të punimeve, shtesës së zërave të preventivit të punimeve shtesë, palët ranë dakord për nënshkrimin e kontratë shtesë për kryerjen e punimeve shtese për rikonstruksioin e sheshit “Rilindja”, Ersekë.

## Neni 2

### Objekti i kontrates

1. Autoriteti Kontraktor i beson Kontraktorit kryerjen e punimeve shtesë per Rikonstruksionin e Sheshit “Rilindja”, Ersekës dhe kthimin e tij në pedonal, ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar, kundrejt pagimit te vleres se kontrates shtesë.
2. Data e fillimit të punimeve shtese do të jetë data 1/07/2015 dhe data e përfundimit te punimeve shtese do te jete data 31/07/2015. Kontrata shtesë bazohet në matje sipas zërave të preventivit të punimeve sipas projektit bashkëlidhur kësaj kontrate shtese.
3. Sigurimi i garancisë së punimeve është ne vlerën 5 % për çdo situacion.

### Neni 3

#### Vlera e kontrates

Vlera për kryerjen e punimeve shtesë për Rikonstrukcionin të Sheshit "Rilindja", Erseke është në shumën 9,500,000.00 (nëntë milionë e pesëqind mijë) leke me TVSH. Fondi i cëluar nga Ministria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit me Nr; 2506/2 prot date 18/02/2015, për vitin 2015 fondi i cëluar për vitin 2015 në vlerën 7,600,000 leke dhe për vitin 2016 në vlerën 1,900,000 leke. Paguesa do të kryhet në rrugë bankare në llogarinë e kontraktuesit:

Banka: Banka Kombëtare Tregtare

Numri i llogarisë: 404222234 (LEK)

### Neni 4

#### Te tjera

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës së datës 25/07/ 2014 të nënshkruar midis palëve do të zbatohen për kryerjen e punimeve shtesë për Rikonstrukcionin e Sheshit "Rilindja", Ersekë, të prokuruar në bazë të legjilacionit të prokurimit. Kontrata shtesë është pjesë përbërëse e kontratës së nënshkruar midis palëve më datë 25/07/ 2014.
2. Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
3. Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
4. KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
5. Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 5

#### Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Në rast mosmarreveshjes, kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kjo kontrate shtesë u hartua ne tre kopje origjinale, dy prej te cilave merren nga Autoriteti Kontraktor dhe nje kopje nga Kontraktuesi.

Kontrata nenshkruhet dhe vuloset ne cdo flete nga te dyja palet.

**PER AUTORITETIN KONTRAKTOR**

**PER KONTRAKTUESIN**

**BASHKIA ERSEKE**

**“AS” SH.P.K.**

**KRYETARI I BASHKISE**

**ADMINISTRATOR**

**ALI LAHO**



**ASLLAN KONI**

